



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-112-6045

Më datë 02.02.2026

Kryetari i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenin 13, nenin 58, paragrafi 1, pika (f) lidhur me nenin 62, paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe nenit 30 dhe 45 paragrafi 1 pika (d) të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të 04.11.2008, e duke u bazuar në Vendimin për emërtimin, organizimin dhe caktimin e numrit të Drejtorive të Komunës së Suharekës, 01-Nr-016-2427 të datës 17.01.2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë

1. Remzi BAJSELMANI i lindur me 28.11.1969 në fshatin Maqitevë, tani me vendbanim të përhershëm në fshatin Sallagrazhde me profesion Master i shkencave të Bilogjisë, **emërohet** Drejtor i Drejtorisë për Arsim në Komunën e Suharekës.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë, janë të përcaktuara me Ligjin Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Suharekës dhe me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës e në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
3. Ky emërim fillon nga data **02 shkurti 2026** dhe i njëjti mandat përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse ky emërim nuk ndërpritet më herët.
4. I lartpërmenduri, brenda tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, është i obliguar të bëjë deklarinimin e pasurisë, në pajtim me nenin 7, lidhur me nenin 8, të Ligjit Nr. 08/L-108, për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 21/2022" si dhe deklarinimin pas përfundimit nga funksioni, brenda afatit tridhjetë (30) ditor, në pajtim me nenin 10, të këtij Ligji.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.



Bali MUHARREMAJ

Kryetari i Komunës

Kopje:
Drejtori Drejtorisë
Zyra e personelit
Arkiva